



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKi  
 Dep. DPKi  
 Nr. i faq. 03  
 Broj stranica 03  
 Nr. pages 03

Nr. Prot. 06-01/2918/22  
 Br. Prot. 06-01/2918/22  
 Prot. No. 06-01/2918/22  
 Data 20-07-2022  
 Datum 20-07-2022  
 Date 20-07-2022



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.07.2022, mori:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPK-06-2140/22*, për zyrtarin e lartë z. Lulzim Beqiri, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Qendrore “Infra Kos”, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-DPK- 06-2140/22, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë, është zhvilluar procedura e paraparë për trajtimin e situatave të konfliktit të Interesit.

Ky rast ka filluar të trajtohet sipas detyrës zyrtare pas informacioneve të marra nga një palë e tretë dhe sipas procedurës Agjencia fillimisht ka marrë informacione nga ARBK (Agjencia Për Regjistrimin e Bizneseve), ku është identifikuar se zyrtari Lulzim Beqiri, figuron të jetë pronar dhe person i autorizuar në biznesin privat me emër “Kuota sh.p.k” .

Pas konfirmimit të informacionit, Agjencia kundër Korrupsionit, sipas procedurës së paraparë, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtari në fjalë ka kontaktuar me zyrtaret e AKK-së, dhe ka kërkuar që të ketë një takim me zyrtaret e AKK-së, për tu njoftuar për rastin e iniciuar për të, e ku pastaj është mbajtur edhe një takim informuese në zyrat e AKK-së, me këtë rast zyrtaret e AKK-së e

kanë njoftuar atë me inicimin e rastit si dhe e kanë njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksion drejtues, respektivisht, menaxhues në biznesin privat, sepse kjo është e ndaluar me neni 13 (paragrafi 1) të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilën thuhet:

1. *Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.*

Ndërsa me nenin 19 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. *Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:*
  - 1.1. *transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];*
  - 1.3. *jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;*
  - 1.4. *dorëhiqet nga funksioni publik.*

Gjatë këtij takimi me zyrtarin e lartë z. Lulzim Beqiri, të quajtur ndryshe edhe si ballafaqim i fakteve, zyrtari i lartë, është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se është emëruar nga ana e Qeveris së Republikës së Kosovës me 09.03.2022, në pronësi ka pasur të regjistruar biznesin me emër “Kuota sh.p.k ” ku nuk ka pasur fare qarkullim, ndërsa me rastin e emërimit si anëtar i bordit në Ndërmarrjen Publike Qendrore “Infra Kos” ka vendosur që aksionet ti bartë tek një aksionar i ri.

Me datën 15.03.2022 kam bërë faljen e aksioneve tek aksionarja e re e kompanisë, dhe e ka ndryshuar statusin e kompanisë sipas ligjit në fuqi.

Arsyeja e ndërrimit të aksionareve në ARBK ka qenë procedurale gjë që me rastin e nënshkrimit nuk jam marrë me, mirëpo kam marrë informacione se lënda është kthyer disa herë për përmirësim për shkak të mangësive që ka pas aplikacioni, e ku njëra nga arsyet ka qenë skadimi i afatit të ID së njërës nga aksionaret por edhe harmonizimi me legjislacionin e ri.

Me gjithë atë ky proces tash më ka përfunduar dhe Agjencisë do i sjell dëshmitë zyrtare të lëshuara nga ARBK, në mënyrë që të dëshmohet që kam shmang papajtueshmërinë në ushtrim të funksionit publik.


Në ndërkohë, Agjencia ka pranuar njoftimin, informacionin zyrtar nga zyrtari Lulzim Beqiri, me të cilën dëshmohet se zyrtari ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe nuk figuron të jetë më pronar dhe person i autorizuar në biznesin privat.

Agjencia kundër Korrupsionit, konstaton se me veprimet e ndërmarra dhe dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë, z. Lulzim Beqiri, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Qendrore “Infra Kos” , duke bartur në mënyrë vullnetare aksionet e biznesin privat me emër “Kuota sh.p.k ” tek pronari tjetër, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

  
Yll Buleshkaj  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit